REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 671/22
Datë/Datum 06.02.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 671/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Ligji nr. 05/L-031, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material hidrosanitari - ndriçim-elektrikë etj, për Administratë, QKMF dhe shkolla", me nr. 624-22-3122-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna Suharekë, me datën 06.02.2023, mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Ndryshohet/ plotësohet Vendimi me nr. të protokollit 671/22, i datës 03.02.2023, që në faqen e parë te këtij vendimi konktretisht tek pika 2, 4 dhe 5 e shënuar si në vijim :

2. **Anulohet,** vendimi i AK- KK Suharekë për dhënie të kontratës për aktivitetin e lartcekur të prokurimit dhe lënda kthehet në rivlerësim.

4. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NTP "Air Tours"- Suharekë, aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

5. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Ndryshohet/plotësohet me fjalinë si më poshtë:

2. **Mbetet në fuqi**, njoftimi për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material hidrosanitari - ndriçim-elektrikë etj, për Administratë, QKMF dhe shkolla", me nr. 624-22-3122-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues- Komuna Suharekë

4. Me qenë se ankesa e për OE NTP "Air Tours"- Suharekë, refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me rastin e përpilimit të Vendimit PSH. nr. 671/22 te dt. 06.02.2023, në faqen e parë është është lëshuar një gabim teknik dhe me këtë rast edhe bëhen plotësimet e duhura sipas këtij Konkluzioni. Kryetari i panelit shqyrtues pasi që është njoftuar se ne vendimin e lartcekur ka lëshime teknike, në pajtim me nenin 50 të Ligjit për Procedurë Administrative Ligji Nr. 05/L -031, me anë të këtij konkluzioni bën korrigjimin e lëshimit duke vendosur si në dispozitiv te këtij konkluzioni.

Kryetari i panelit shqyrtues konform nenit 50 të Ligji Nr. 05/L -031, si dhe duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës komerciale- në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK – AME
1x1 OE ankues
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.